

Shoqëria për shërbime dhe kurse për gjuhë të huaja IN dhe OUT është prezent në tregun maqedonas nga shtatori i vitit 2001, duke nisur të punoj si shkollë për gjuhë të huaja për ta përhapur më pas veprimtarin e saj dhe të ritet në agjenci të përkthimeve e cila në ditën e sotme paraqitet si lider i tregut në këtë sferë dhe ka arritur të krijoj besim tek konsumatorët, si rezultat i shërbimeve të ofruara cilësore dhe profesionale.

Kompania disponon me hapësira të saja afariste dhe hapësira zyrash të nevojshme për aktivitetet e parapara si dhe mjete tjera bashkëkohore të cilat mundësojnë përmbushjen efikase dhe ekzakte të shërbimeve intelektuale. Ekipi punues është i përbërë nga profesionistë me kualifikim të lartë, të cilët disponojnë me dituri specifike dhe përvojë të nevojshme nga lëmit përkatëse dhe të cilët u përgjigjen kërkesave të klientëve në kohë.

Zhvillimi i kompanisë ka kontribuar mbi suksesin profesional dhe bashkëpunimin e suksesshëm me shumë institute qeveritare (Sekretariatit për Çështje Evropiane, Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, Ministrinë për Punë dhe Politik Sociale të RM, Ministrinë e Ekonomisë së RM, Sekretariatit për Legjislativë të RM, Fondin për Sigurim Shëndetësor të RM, Njësinë e projektit për koordinim të Ministrisë së Shëndetësisë të RM dhe tjera), institute qeveritare të huaja (Sekretariati Gjeneral i Republikës së Sllovenisë), organizata joqeveritare (Fondacioni i Ballkanit për Fëmijë dhe të Rinj, Edukim Global, Instituti për Menaxhim të mirë dhe për Perspektiva Euroatlantike) dhe shumë kompani private të vendit dhe të jashtme (Normak Projekt, Astreks, SINTEF, BAR E.C.E, Star Grup-Sllovenia, AD MEPSO, Postat e Maqedonisë, Bi- Mek, Komuna SHA- Shkup, Konsultime urbane- rural Shkup, Urban Invest, Instituti Nacional për Demokraci-Shkup).

Kompania vazhdon të jetë lider i tregut në vendin tonë dhe në regjion përmes shërbimeve të mëtejme profesionale, cilësore dhe në kohë, si dhe përmes investimit të kapacitete të veta profesionale dhe teknike.